

**NDIKIMI ITALIAN NË ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE POLITIK TË
SHQIPËRISË GJATË VITEVE 1925-1939**

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I SHKENCËS NË HISTORI TË KOHËS SË RE

NGA

FLAKRON CANI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

Mars, 2024

REZYME

NDIKIMI ITALIAN NË ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE POLITIK TË SHQIPËRISË GJATË VITEVE 1925-1939

Mentori

Prof. Ass. Dr: MENTOR HASANI

Punimi synon që të mësoj për zhvillimin ekonomik e politik të Shqipërisë e cila kishte dalë nga Lufta e Parë Botërore me një ekonomi shumë të dobët dhe me një politik të brendshme jo të qëndrueshme dhe se i duhej patjetër një aleat i huaj për zhvillim. Punimi ka për qëllim të tregoj se përse Shqipëria zgjodhi pikërisht Italinë, si u rrit ndikimi i saj në vend dhe a kishte mundësi që Shqipëria ti ikte trysnis italiane.

Punimi ka për qëllim të paraqesë ndikimin italian në ekonominë por edhe në politikën e Shqipërisë gjatë viteve 1925-1939, si ndikuan marrëveshjet italo-shqiptare për futjen e kapitalit e italian në Shqipëri i cili gradualisht filloi ta mboshte kapitalin vendas, si ndikuan këto marrëveshje në politikbërjen e shtetit shqiptarë. Punimi gjithashtu synon të mësojë se sa ndikuan investimet e ndërrmarjeve dhe shoqërive italiane në zhvillimin ekonomik të vendit, a ishte zhvillim pozitiv a negativ.

Punimi në fjalë është i ndarë në 3 krerë apo kapituj

Në kreun e parë **‘Zhvillimi ekonomik në Shqipëri dhe marrëdhëniet me Italinë’**, do të flasim për ekonominë e vendit në periudhën e Republikës, për vështërsitë që kaloi vendi dhe se si filloi të marrë vetën pas Luftës I Botërore dhe rrethanave të kohës, si filloi të depërtoj në ekonominë e vendit kapitali i huaj duke marrë koncesione të shumta, ku nga më të rëndësishmit ishin koncesioni i vajgurit e i monedhes dhe kreditit. Pastaj do të flasim, për Koncesionet dhe investimet italiane në Shqipëri, për huan SVEA, cilat degë të ekonomisë preku ky kapital a pati ndikim pozitiv

në zhvillimin e ekonomisë së vendit, cillat qenë investimet e parapara fillimishtë dhe në qfarë u investua në të vërtetë. Do të flasim edhe për rrethanat që çuan deri tek themelimi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë, për projektet që iu paraqitën qeverisë shqiptare për themelimin e kësaj banke, e deri tek marrëveshja e vitit 1925 për themelimin e bankës dhe do të flasim se si kjo Bankë kaloi pothuajse e tëra në duart e Italisë duke i lënë asaj vetëm emrin Shqiptare. Në fund do të flasim edhe për zhvillimet politike dhe efektet e nënshkrimit të dy pakteve 1926-1927 të Tiranës ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, cillat kan qenë shkaqet dhe pasojat e këtyre pakteve, sa ishin të dëmshme ose të dobishme për Shqipërinë dhe se si ndikuan në marrëdhëniet me Italinë në vitet në vazhdim.

Kreu i dytë **‘Zhvillimet politike me impakt ekonomikë në Shqipëri gjatë viteve 1928-1935’** trajton fillimisht pasojat e krizës ekonomike në Shqipëri dhe përpjekjet e Italisë për të tejkaluar këtë krizë, fletë për gjendjen e rëndë të vendit të shkaktuar nga kriza, goditjen e rëndë që e pësoi industria e vendit, ku u mbyllën një numër shumë i madhë i ndërrmarjeve dhe fabrikave shqiptare si dhe paksimin e produkteve bujqësore e blegtorale. Kreu flet edhe për përpjekjet e Ahmet Zogut për të realizuar një reformë agrare dhe zhvillimet që e karakterizuan atë, ktu kemi arritjen e një reforme agrare në vitin 1930, nga mbreti, por që rezultatet e reformës nuk kishin dalur siq ishte pritur pasi që shtresa feudale e vendit kishte bërë përpjekje të vazhduëshme për mos realizimin e saj. Në fund flitet edhe për rritjen e ndikimit italian në politikën dhe ekonominë e vendit dhe acarimin e marrëdhënieve midis dy vendeve, kemi një periudhë të ftohjes së marrëdhënieve gjatë viteve 1931-1934 që pati pasoja negative për ekonomin e vendit. Në këtë kre do të flasim për fillimin e rezistencës së Ahmet Zogut ndajë trysinsë së Italisë e Musolinit i cili i kishte parë qëllimet e Italisë, por që përshkakë të gjendjës së rëndë ekonomike të vendit të shkaktuara nga kriza ekonomike, zija bukës, eksporti i kufizar, e detyruan Ahmet Zogun që të kthehej përsëri nga Italia për të kërkuar ndihma për të dalë nga kriza.

Kreu i tretë **‘Varsia ekonomike dhe dominimi italian në ekonominë dhe politikën shqiptare 1936-1939’** ktu fillimisht flasim për zhvillimin ekonomik të vendit gjatë viteve 1936-1939, vendi pati një zhvillim relativisht të mirë gjatë këtyre viteve të cilat i paraprinë krizës ekonomike, degë të ndryshme të ekonomisë filluan ta marrin vetën dalëngadalë, i rihapën shumë fabrika e ndërrmarje të ndryshme. Pastaj do të flasim për marrëdhëniet italo-shqiptare gjatë këtyre viteve, ku kemi marrëveshjet ekonomike, politike të marsit të vitit 1936, për zhvillimin ekonomik të vendit

dhe rritjen e ndikimit italian në Shqipëri, ktu do flasim për disa prej marrëveshjeve më të rëndësishme, si ndikuan ato në zhvillimin ekonomik të vendit, a ishin të dobishme për shtetin shqiptarë, apo ishin vetëm një lojë tjetër e Italisë për të rritur ndikimin e sajë. Pastaj do të flasim për Shqipërinë në marrëdhëniet italo-jugosllave, për pazaret që bënë Italia me kontin Çiano dhe Jugosllavia e Stojadinoviçit për ndarjen e Shqipërisë mes tyre dhe pajtimin për një pushtim të mundshëm të Shqipërisë nga Italia. Në fund do të flasim për pushtimin e Shqipërisë nga Italia më 7 prill 1939, pas planeve të shumta të bëra nga ministri i jashtëm italian Çiano dhe Musolini, përmes së cilit u përmbushën synimet afatgjate të Italisë që i kishte në Shqipëri. Do të flasim edhe se qfarë qendrimi mbajti Ahmet Zogu me qeverinë e tij dhe për qëndresën e popullit shqiptarë ndaj agresionit italian.